

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar i Avancuar  
Advanced Financial Reporting

**P9**

**Zgjidhjet**

FLETË PROVIMI  
Exam Paper

Data  
15.06.2019

CONTENT / PËRMBAJTJA

<b>Pjesa</b>	<b>Maksimumi i Dhënë</b>	<b>-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga <u>ShKÇAK-PIKËT E DHËNA</u></b>
1. Problemi 1	30	
2. Problemi 2	10	
3. Problemi 3	20	
4. Problemi 4	20	
5. Problemi 5	20	
<b>Total</b>	<b>100</b>	

1. Arya sh.a është formuar më shumë se 40 vite më parë. Arya sh.a dhe filialet e saj mirren më mallra të ndryshme duke përfshirë: çimenton, pjesët e veturave dhe paisje teknike për dyqane të ushqimit. Kompanitë kanë disa pika të shitjeve në 10 vende të kontinentit të Westeros.

Ju jeni kontabilist i grupit Arya sh.a. Draft Pasqyrat e Pozitës Financiare në vijim kanë të bëjnë me Arya sh.a, Daenerys sh.a dhe Sansa sh.a me 31 dhjetor 2018.

	Arya sh.a €'000	Daenerys sh.a €'000	Sansa sh.a €'000
<b>Pasuritë</b>			
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>			
Prona, fabrika dhe paisjet	1,176.70	1,050.00	630.00
Investimet në:			
Daenerys sh.a	365.00	-	-
Sansa sh.a	<u>107.50</u>	<u>430.00</u>	<u>-</u>
	1,649.20	1,480.00	630.00
<i>Pasuritë qarkulluese</i>	<u>973.30</u>	<u>546.00</u>	<u>483.00</u>
<b>Total Pasuritë</b>	<b>2,622.50</b>	<b>2,026.00</b>	<b>1,113.00</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>			
<i>Ekuiteti</i>			
Aksionet e zakonshme prej €0.50 secila	483.00	399.00	378.00
Komponentët tjerë të ekuitetit	220.50	178.50	157.50
Fitimet e mbajtura	<u>312.50</u>	<u>(52.50)</u>	<u>126.00</u>
<i>Total ekuiteti</i>	1,016.00	525.00	661.50
<i>Detyrimet</i>			
Detyrimet afatgjata	1,260.00	1,096.50	357.00
Detyrimet afatshkurtëra	<u>346.50</u>	<u>404.50</u>	<u>94.50</u>
<i>Total detyrimet</i>	<u>1,606.50</u>	<u>1,501.00</u>	<u>451.50</u>
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>2,622.50</b>	<b>2,026.00</b>	<b>1,113.00</b>

**Informatat në vijim janë të rëndësishme për përgaditjen e pasqyrave të konsoliduara:**

- i). Arya sh.a bleu 80% të aksioneve të ekuitetit të Daenerys sh.a dhe 15% të aksioneve të ekuitetit të Sansa sh.a me 1 janar 2015 për një konsideratë në para prej €365,000 dhe €107,500 respektivisht. Vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme e Daenerys sh.a ishte €449,000. Në datën e njejtë, komponentët tjerë të ekuitetit dhe fitimet e mbajtura të Daenerys sh.a ishin €31,500 dhe €10,500 respektivisht. Teprica mbi vlerën e drejtë të pasurive neto të identifikueshme ka të bëjë me tokën që nuk zhvlerësohet.
- ii). Daenerys sh.a bleu 60% të aksioneve të ekuitetit të Sansa sh.a me 31 dhjetor 2015 për një konsideratë në para prej €430,000. Vlerat e drejta të pasurive neto të identifikueshme ishin €488,200 dhe €469,200 me 31 dhjetor 2015 dhe 1 janar 2015 respektivisht. Me 31 dhjetor 2015, komponentët tjerë të ekuitetit dhe fitimet e mbajtura ishin €94,500 dhe €35,700

respektivisht, ndërsa me 1 janar 2015 komponentët tjerë të ekuitetit dhe fitimet e mbajtura ishin €80,500 dhe €30,700 respektivisht. Deficiti në vlerat e drejta kishte të bënte me një zë të fabrikës. Fabrika kishte jetë ekonomike të përdorimit prej pesë (5) viteve me 1 janar 2015. Vlera e drejtë e pronësisë prej 15% të Arya sh.a-së në Sansa sh.a me 31 dhjetor 2015 ishte ende €107,500.

iii). Me 31 dhjetor 2018 Arya sh.a shiti të gjitha aksionet (100%) të interesit në ekuiteti të Nymeria sh.a për një konsideratë në para prej €190,000. Arya sh.a bleu 100% të interesit në ekuitetin e Nymeria sh.a me 1 janar 2011 për një konsideratë në para prej €182,000. Vlerat e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të Nymeria sh.a-së ishin €240,000 dhe €180,000 me 31 dhjetor 2018 dhe 1 janar 2011 respektivisht. Zëri i mirë nuk ishte dëmtuar deri në datën e shitjes.

Ky transaksion është regjistruar drejtë në librat individual të Arya sh.a-së.

- iv). Daenerys sh.a dhe Sansa sh.a nuk kanë emetuar aksione tjera shtesë që nga datat e blerjes së tyre si dhe korigjimet e vlerave të drejta të referuara në i) dhe ii) mësipër nuk janë inkorporuar në pasyrat e mësipërme të pozitës financiare.
- v). Investimet në Daenerys sh.a dhe Sansa sh.a ishin klasifikuar si pasuri financiare nëpërmjet të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse në pajtim me SNRF 9 '*Instrumentet Financiare*'. Investimet janë të paraqitura në pasqyrën e pozitës financiare të Arya sh.a sipas kostos. Kjo për shkak se ndryshimet në vlerat e drejta ishin jo-materiale.
- vi). Zëri i mirë në Daenerys sh.a dhe Sansa sh.a nuk është dëmtuar me 31 dhjetor 2018.
- vii). Është politikë e grupit të vlerësoj interesin jo-kontrollues duke përdorur metodën proporcionale të pasurive neto.

**Kërkohet:**

**Përgadite Pasqyrën e Konsoliduar të Pozitës Financiarë të grupit Arya sh.a me 31 dhjetor 2018.**  
**(30 pikë)**

**1.**

a) Llogaritja e fitimit në shitjen e 100% të aksioneve në Nymeria sh.a.

	<b>€'000</b>
Konsiderata e pranuar	190
Kosto e investimit të shitur	<u>182</u>
Fitimi	8

**Grupi Arya sh.a.****Pasqyra e Konsoliduar e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2018**

	<b>€'000</b>
<b>Pasuritë</b>	
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>	
Prona, fabrika dhe paisjet (1,176.7+1,050+630+8L11- 20L11+15L11)	2,859.70
Zëri i mirë (L11)	<u>149.73</u>
	3,009.43
<i>Pasuritë qarkulluese (973.30+546+483)</i>	<u>2,002.30</u>
<b>Total Pasuritë</b>	<b>5,011.73</b>
<b>Ekuiteti dhe detyrimet</b>	
<i>Ekuiteti</i>	
Aksionet e zakonshme prej €0.50 secila	483.00
Komponentët tjerë të ekuitetit (L13)	377.79
Fitimet e mbajtura (L14)	<u>328.44</u>
	1,189.23
Interesi jo-kontrollues (L15)	<u>263.50</u>
<i>Total Ekuiteti</i>	1,452.73
<i>Detyrimet</i>	
Detyrimet afatgjata(1,260+1,096.50+357)	2,713.50
Detyrimet afatshkurtëra (346.50+404.50+94.50)	<u>845.50</u>
<i>Total Detyrimet</i>	3,559.00
<b>Total ekuiteti dhe detyrimet</b>	<b>5,011.73</b>

Llogaritjet		
<b>L11 Zëri i mirë</b>	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
<u>Daenerys sh.a</u>		
Kosto e investimit		365.00
Interesi jo-kontrollues në blerje		<u>89.80</u>
Vlera e drejtë e pasurive neto të blera:		
Aksionet e zakonshme	399.00	
Komponentët tjerë të ekuitetit	31.50	
Fitimet e mbajtura	10.50	
Korrigjimet e vlerës së drejtë (shif. balancuese)	<u>8.00</u>	
Vlera e drejtë e pasurive neto të blera		<u>449.00</u>
Zëri i mirë		5.80
Minus: Humbja nga dëmtimi		-
		<b>5.80</b>
<u>Sansa sh.a</u>		
Kosto e investimit:	Direkt 15%	107.50
	Indirekt (80% x 430)	344.00
Interesi jo-kontrollues në blerje		180.63
Vlera e drejtë e pasurive neto të blera:		
Aksionet e zakonshme	378.00	
Komponentët tjerë të ekuitetit	94.50	
Fitimet e mbajtura	35.70	
Korrigjimet e vlerës së drejtë (shif. balancuese)	<u>(20.00)</u>	
Vlera e drejtë e pasurive neto të blera		<u>488.20</u>
Zëri i mirë		143.93
Minus: Humbja nga dëmtimi		-
		<b>143.93</b>
<b>Total Zëri i mirë</b>		<b>149.73</b>

Zhvlerësimi shtesë i korigjimit të vlerës së drejtë:  $(20 \times 3/4 \text{ vite}) = 15.00$

## L12 Llogaritja e humbjes - shitja e 100% të Nymeria sh.a

	<b>€'000</b>
Konsiderata e pranuar	190.00
Minus: VD e pasurive neto në shitje	(240.00)
Zëri i mirë (182 - 180)	<u>(2.00)</u>
<b>Humbja në shitje</b>	<b>52.00</b>

<b>L13 Komponentët tjerë të ekuitetit</b>	<b>€'000</b>
Arya sh.a	220.50
Pjesa pas blerjes:	
Daenerys sh.a [80% x (178.5-31.5)]	117.60
Sansa sh.a [63% x (157.5-94.5)]	<u>39.69</u>
	377.79

<b>L14 Fitimet e mbajtura</b>	<b>€'000</b>
Arya sh.a	312.50
Pjesa e pas blerjes në: Daenerys sh.a [80% x (-52.5-10.5)]	(50.40)
Sansa sh.a [63% x (126-35.7+15L11)]	66.34
Nymeria sh.a 100% x (240-180)	60.00
Anulimi i fitimit	(8.00)
Humbja në shitje L12	<u>(52.00)</u>
	328.44

<b>L15 Interesi jo-kontrollues</b>	<b>€'000</b>	<b>€'000</b>
Daenerys sh.a		
Në blerje	89.80	
Minus: Pjesa e investimeve në Sansa sh.a (20% x 430)	(86.00)	
Pjesa e pas blerjes:		
Komponentët tjerë të ekuitetit (20% x 147)	29.40	
Fitimet e mbajtura (20% x (- 63))	<u>(12.60)</u>	
		<u>20.60</u>
Sansa sh.a		
Në blerje	180.63	
Pjesa e pas blerjes:		
Komponentët tjerë të ekuitetit (37% x 63)	23.31	
Fitimet e mbajtura (37% x 105.3)	<u>38.96</u>	
		<u>242.90</u>
<b>Total</b>		<b>263.50</b>

2.

a) Brienne sh.a është një kompani e listuar ë bursë e cila monton kompjuter personal dhe është duke i përgaditur pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 maj 2018. Brienne sh.a planifikon të mbyllë njërin nga divizionet e saj. Ky divizion, i cili është i klasifikuar si një segment i ndarë biznesor do t'i ndërpres të gjitha aktivitetet e tij me 28 shkurt 2019. Shumica e pasurive të biznesit do të zhvendosen në bizneset tjera të Brienne sh.a-së. Megjithatë, disa zëra të fabrikës do të shiten ose do të largohen për skrap. Përafërsisht gjysma e stafit të divizionit do të jenë teprice dhe janë njoftuar lidhur me vendimin në fund të dhjetorit 2018. Klientët dhe furnitorët janë njoftuar në të njëjtën kohë. Pasqyrat vjetore të vitit 2018 janë planifikuar të publikohen me 9 mars 2019.

**Kërkohet:**

**Këshilloni drejtorët lidhur me raportimin financiar të çështjeve që kanë rrjedhur nga ngjarja mësipër dhe shpjegoni trajtimin e duhur në kontabilitet në pasqyrat financiare të Brienne sh.a-së. (6 pikë)**

b) Ygritte sh.a ka hyrë në një zotim kontraktual për t'i dhënë një kredi një klienti me normë variabile të interesit duke filluar nga 1 janar 2019 për një periudhë fikse me normë prej 1 pikë përqindje më pak së norma me të cilat entiteti (jo klienti) mund të huazoj para.

**Kërkohet:**

**Këshillo drejtorët e Ygritte sh.a për trajtimin në kontabilitet të këtij transaksioni sipas SNRF 9: *Instrumentet Financiare* për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2018. (4 pikë)**



## 2. a)

### **SNRF 5 Pasuritë Jo-qarkulluese të Mbajtura për Shitje dhe Operacionet e Ndërprera.**

Çështja këtu është nëse mbyllja e divizionit duhet të kontabilizohet si një operacion i ndërprerë sipas SNRF 5 Pasuritë Jo-qarkulluese të Mbajtura për Shitje dhe Operacionet e Ndërprera. Një operacion i ndërprerë është i definuar si një komponent i një entiteti i cili ose është larguar/ shitur ose është mbajtur për shitje dhe:

- a) paraqet një linjë të madhe të biznesit ose hapësire gjeografike të operacioneve, ose
- b) është pjesë e një plani të koordinuar për largim/ shitje të një pjesë të madhe të veçantë të biznesit apo hapësire gjeografike të operacioneve, ose
- c) është një filial i blerë posaçërisht me qëllim të rishitjes.

Pasi që operacioni i ndërprerë nuk është larguar/shitur në fund të vitit, mundet vetëm të klasifikohet si i ndërprerë në pasqyrat financiare të vitit 2018 nëse përmbush përkufizimin e “i mbajtur për shitje”. Grupet e largimit/shitjes klasifikohen si të mbajtura për shitje nëse “vlera e tyre bartëse do të rikuperohet kryesisht nëpërmjet një transaksioni të shitjes e jo nga përdorimi i vazhdueshëm”.

Ky nuk është rasti këtu pasi që shumica e pasurive janë duke u zhvendosur në pjesët tjera të biznesit.

Pasuritë në shuma të vogla mund të klasifikohen si të mbajtura për shitje nëse të gjitha kriteret përkatëse përmbushen, por jo si një operacion i ndërprerë..

### **SNK 37 Provizionet, detyrimet kontigjente dhe pasuritë kontigjente**

Provizioni duhet të ndahet për një kosto të stafit tepricë nëse ekziston një obligim konstruktiv në fund të vitit. Me sa duket në këtë rast, duke supozuar se një plan formal për ristrukturim është bërë, entiteti ka krijuar pritje të vlefshme tek ata që janë afektuar se ristrukturimi do të kryhet pasi që ata janë njoftuar para përfundimit të vitit se do të jenë punëtorë të tepërt.

### **SNK 10 Ngjarjet pas periudhës raportuese**

Mbyllja duhet të shpaloset si një ngjarje jo-korrigjuese pas periudhës së raportimit për shkak të rëndësisë së saj në biznes (është një segment operativ i veçantë).

## b)

### **Zotimet për të dhënë kredi me norme më të ulët të interesit se sa normat e interesit në treg**

Zotimet për t'i dhënë një kredi klienti duket se janë bërë më normë më të ulët se sa ajo e tregut, duke qenë se norma është më e ulët se ajo me të cilën entiteti mund të huazoj para në treg. Një zotim për të dhënë kredi me një normë më të ulët se ajo e tregut paraqet një detyrim financiar. Kjo është për shkak se entiteti ka një obligim për të paguar më shumë interes në financimin e kredisë se sa shuma e pranuar nga klienti.

Zotimi është bërë në vitin 2018 dhe fillimisht matet sipas vlerës së drejtë.

Të hyrat nga interesi njihen nga kjo shumë duke përdorur metodën efektive të interesit.

Në fund të vitit, detyrimi rritet në vlerësimin sipas SNK 37 (provizionet) (vlerësimi më i mirë i shpenzimeve që kërkohen për të shlyer detyrimin), nëse kjo shumë e tejkalon vlerën e drejtë të matur në fillim minus shumat e amortizuara tek fitimi ose humbja duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Çfarëdo difference ngarkohet në fitim ose humbje.

3.

a) Tyrion sh.a ka punësuar z. Bronn për një periudhë kontraktuale prej 3 viteve duke filluar nga 1 janar 2018. Si pjesë e pakos së kompenzimit, z. Bronn i është premtuar përfitim i një shume të vetme prej 5% të pagës së fundit vjetore për çdo vit të shërbimit.

Ai paguhet një pagë mujore prej €15,000 e cila rritet 10% (interes i përberë) në viti. Tyrion sh.a përdor një normë të skontimit prej 7% e cila është një normë e ofruar nga shumica e obligacioneve.

Tabela e vlerave të tanishme:

Periudha	5%	7%	10%
1	0.9524	0.9346	0.9091
2	0.9070	0.8734	0.8265
3	0.8638	0.8163	0.7513

**Kërkohe:**

**Llogaritë për secilin vit koston e interesit, koston e shërbimeve aktuale dhe përfitimet e pensionimit që do të paguhet nga Tyrion sh.a për z. Bronn në fund të vitit 2020. (10 pikë)**

b) Një kompani filial ka marrë një kredi pa interes nga kompania prind për t'i paguar furnitorët e saj. Kjo është hera e parë që kompania ka kërkuar ndihmë nga kompania e saj prind në 5 vitet e fundit. Sipas marrëveshjes kontraktuale të shkruar, shuma e plotë e kredisë pritet të kthehet pas 3 muajve.

**Kërkohe:**

**Identifiko nëse kredia trajtohet sipas SNRF 9 *Instrumentet Financiare*. (2 pikë)**

c) Një entitet aplikon kontabilitetin e mbrojtjes për mërrëdhëniet e mbrojtjes që përmbushin kriteret e kualifikimit.

**Kërkohe:**

**Shpjego tri (3) llojet e marrëdhënive të mbrojtjes. (6 pikë)**

d) Mosparaqitjet apo paraqitja e gabuar e zërave në vitet e kaluara kërkon riparqitje retrospektive të pasqyrave financiare.

**Kërkohe:**

**Shpjego "riparaqitjen retrospektive" siç është përmendur mësipër. (2 pikë)**

3.

a)

$$15,000 \times 1.1 \times 1.1 = 18,150 \times 12 = 217,800 \times 5\% = 10,890$$

Viti	1	2	3
Përfitimet vitet e kaluara	-	10,890	21,780
Përfitimet viti aktual	10,890	10,890	10,890
Përfitimet viti aktual dhe i kaluar	10,890	21,780	32,670
Obligimi në fillim	-	9,511	20,355
Interesi 7%	-	666	1,425
Kosto e shërbimeve aktuale	$10,890 \times 0.8734 = 9,511$	$10,890 \times 0.9346 = 10,178$	$10,890 \times 1.000 = 10,890$
Obligimi në fund	<b>9,511</b>	<b>20,355</b>	<b>32,670</b>

b) Sipas SNRF 9 *Instrumentet Financiare* sepse:

- Ka një kontratë të shkruar
- Pagesa në kohë të shkurtë (nuk është permanente)
- Nuk ka pasur shenja të përsëritjes së marrjes së kredisë

c) Ka tri lloje të marrëdhënieve të mbrojtjes:

- Mbrojtja e vlerës së drejtë:* mbrojtja e ekspozimit ndaj ndryshimeve në vlerën e drejtë të një pasurie apo detyrimi apo të një zotimi të paregjistruar nga kompania, apo një komponent të një zëri të tillë i cili i atribuohet një rreziku të caktuar që mund të afektoj fitimet ose humbjet.
- Mbrojtja e rrjedhës së parasë:* një mbrojtje e ekspozimit ndaj një ndryshimi në rrjedhat e parasë që i atribuohet një rreziku të caktuar që lidhet me të gjitha apo një komponent të një pasurie të njohur apo një detyrimi (siç janë disa apo të gjitha pagesat e ardhshme të interesit në një borxh me norme variable të interesit) ose një transaksioni të parashikuar më probabilitet të lartë të ndodhjes, i cili mund të ndikoj në fitim ose humbje.
- Mbrojtja e një neto investimit në një operacion të huaj.*

d) Ri paraqitja retrospektive është korigjimi i njohjes, matjes dhe shpalosja e shumave të elementeve të pasqyrave financiare sikur gabimi i periudhës paraprake.

4.

(a)

SNRF 13 *Matjet e vlerës së drejtë* jep udhëzime për matjen e vlerës së drejtë aty ku një SNRF specific kërkon ose lejon matjen e vlerës së drejtë si bazë të matjes. Siguron një kornizë të vetme të SNRF-ve për matjen e vlerës së drejtë dhe kërkon shpalesje për matjen e vlerës së drejtë. Standardi definon nocionin e vlerës së drejtë në bazë të “çmimit dalës” dhe përdor një “hierarki të vlerës së drejtë”, e cila rezulton në matje të bazuara në treg më shumë së matjet specifike për entitetin.

**Kërkohet:**

**Shpjego kërkesat e përgjithshme të SNRF 13 që kanë të bëjnë me vlerën e drejtë dhe hierarkinë e vlerës së drejtë. (8 pikë)**

(b)

Instrument financiar është çdo kontratë që i jep një pale pasuri financiare (një entiteti) dhe detyrim financiar ose instrument të ekuitetit palës tjetër. Do të na ndihmonte sikur ta mendonim një instrument financiar si një copë letre, pasi që kontratat zakonisht shkruhen. Me 24 korrik 2014, BSNK-ja publikoi verzionin final të SNRF 9 *Instrumentet financiare*, duke inkorporuar modelin e demtimit të humbjeve të pritura dhe paraqiti ndryshime të kufizuara të kërkesave të klasifikimit dhe matjes së pasurive financiare. SNRF-ja është e ndërtuar në një qasje logjike dhe të vetme të klasifikimit dhe matjes së pasurive financiare të cilat reflektojnë modelin e biznesit në të cilat ato menaxhohen dhe karakteristikat e rrjedhave të tyre të parasë.

**Kërkohet:**

**Shpjego njohjen fillestare, matjen dhe klasifikimet fillestare të cilat i identifikon SNRF 9 *Instrumentet financiare* për pasuritë financiare dhe bazat e matjes të cilat janë të përshtatshme për secilin klasifikim. Ju duhet të identifikoni përjashtimet ndaj klasifikimit të zakonshëm të cilat mund të aplikohen në situata specifike. (6 pikë)**

(c)

The Iron Bank sh.a nga qyteti Braavos emetoi obligacion të konvertueshëm në shumë prej €10 milion 6% me 31 mars 2019 në vlerën nominale. Obligacioni është i ripagueshëm në vlerën nominale me 31 mars 2024 ose mund të konvertohet në atë datë në 20 aksione të zakonshme prej €1 për çdo €100 të obligacioneve të mbajtura.

**Kërkohet:**

**Shpjego se si ky obligacion i emetuar do të regjistrohet fillimisht në Pasqyrën e Pozitës Financiare të The Iron Bank sh.a me 31 mars 2019, në pajtim me SNK 32 *Instrumentet Financiare: Prezantimi*.**

**Shënim: Llogaritjet nuk kërkohen vetem shpjegimi**

**(2 pikë)**

**(d)**

The Iron Bank sh.a gjithashtu emetoi me 1 prill 2018 4 milion €1 aksione preferenciale kumulative të ripagueshme në vlerën nominale. Aksionet bartin një norme fikse të kuponit prej 6%, e cila paguhet na baza vjetore ne fund të vitit. Ato ripaguhen me 31 mars 2022 më një premi prej €300,000. The Iron Bank sh.a kishte kosto të transaksionit prej 1% me 1 prill 2018 në shumën e arkëtuar të emetuar. Norma efektive e interesit lidhur me këto aksione është përafërsisht 7.97%.

**Kërkohe:**

**Në pajtim me SNK 32 *Instrumentete Financiare: Prezantimi* dhe SNRF 9 *Instrumentet Financiare*:**

- (i) Përgaditi hyrjet në ditar për të regjistruar emetimin e aksioneve dhe kostotet e transaksionit; dhe (2 pikë)**
- (ii) Llogarite vlerën bartëse të aksioneve preferenciale që do të përfshihen në Pasqyrën e Pozitës Financiare të The Iron Bank sh.a me 31 mars 2019. (2 pikë)**

#### 4.

##### (a)

SNRF 13 definon vlerën e drejtë si çmimin që do të pranohej për të shitur një pasuri apo paguhej për të transferuar një detyrim në një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve në treg në datën e matjes. Objektivi i matjes së vlerës së drejtë është vlerësimi i çmimit në të cilin një transaksion i rregullt për të shitur një pasuri apo transferuar një detyrim do të ndodhte ndërmjet pjesëmarrësve në treg në datën e matjes sipas kushteve aktuale në treg. SNRF 13 aplikohet tek SNRF-të të cilat kërkojnë apo lejojnë matjet e vlerës së drejtë apo shpalosjet për matjet e vlerave të drejta (dhe matjet, të tilla si vlera e drejtë minus kostot për ta shitur, bazuar në vlerat e drejta apo shpalosjet për këto matje), përveç në kushte të specifikuara.

Një matje e vlerës së drejtë kërkon që një entitet të përcaktoj të gjitha në vijim:

1. pasuria apo detyrimi i veçantë që është subjekt i matjes (që konsiston me njësinë e llogarisë)
2. për një pasuri jo-financiare, premisa e vlerësimit që është e përshtatshme për matjen (që konsiston me përdorimin më të lartë dhe më të mirë)
3. tregu kryesor (apo më i përparuar)për pasurinë apo detyrimin
4. teknikat e vlerësimit të përshtatshme për matjen, duke konsideruar disponueshmërinë e të dhënave me të cilat zhvillohen inputet të cilat paraqesin supozimet që pjesëmarrësit në treg do të përdornin kur të vendosin çmimin e pasurisë ose detyrimit dhe nivelin e hierarkisë së vlerës së drejtë brenda së cilës inputet janë kategorizuar.

SNRF 13 siguron udhëzim në matjen e vlerës së drejtë, përfshirë si në vijim:

Një entitet duhet të i marrë parasysh karakteristikat e pasurisë ose detyrimit që është objekt i matjes të cilat një pjesëmarrës në treg do t'i merrte parasysh gjatë vendosjes së çmimit të pasurisë apo detyrimit në datën e matjes (p.sh. kushtet dhe lokacionin e pasurisë dhe çfardo kufizimi në përdorimin dhe shitjen e pasurisë.

Matja e vlerës së drejtë supozon një transaksion të rregullt ndërmjet pjesëmarrësve në treg në datën e matjes sipas kushteve aktuale të tregut.

Matja sipas vlerës së drejtë supozon që transaksioni ndodh në tregun kryesor të pasurisë apo detyrimit, ose në mungesë të një tregu kryesor, tregun më të përparuar për pasurinë apo detyrimin.

Një matje e vlerës së drejtë të një pasuri jo-financiare merr në konsideratë përdorimin më të lartë dhe më të mirë.

Një matje e vlerës së drejtë të një pasurie apo detyrimi financiar ose të instrumenteve të vet të ekuitetit të kompanisë supozon që është transferuar tek pjesëmarrësit në treg në datën e matjes, pa anulim, shlyerje apo shuarje në datën e matjes.

Vlera e drejtë e një detyrimi reflekton rrezikun e mos-përformimit (rrezikun që një entitet nuk do të përmbush një detyrim), përfshirë rrezikun e vet kreditor të kompanisë dhe supozon rrezik të njejtë të mos-përformimit para dhe pas transferit të detyrimit.

Një përjashtim opcional aplikohet për disa pasuri financiare dhe detyrime financiare të cilat mund të anulohen për rrezikun e tregut apo rrezikun e pales së kundërt, nëse kushtet e caktuara përmbushen (kërkohen shpalosje shtesë).

### Hierarkia e vlerës së drejtë

Për të rritur konsistencën dhe krahasueshmërinë në matjet e vlerës së drejtë dhe shpalosjet përkatëse, SNRF-të vendosin një hierarki e cila kategorizon në tri nivele inputet në teknikat e vlerësimit të përdorura për të matur vlerën e drejtë. Hierarkia e vlerës së drejtë i jep prioritet më të lartë çmimeve të kuotuar në treg (të pakorigjuara) në tregjet aktive për pasuri ose detyrime identike (inputet e nivelit 1) dhe prioritet më të ulët inputeve të paobservueshme (inpute të nivelit 3).

Inputet e nivelit 1 janë çmimet e kuotuar (të pakorigjuara) në tregje aktive për pasuri apo detyrime identike në të cilat entiteti mund të këtë qasje në datën e matjes. Inputet e nivelit 2 janë inpute të tjera nga çmimet e kuotuar brenda nivelit 1 të cilat janë të observueshme për pasurinë apo detyrimin, ose direkt ose indirekt. Inputet e nivelit 3 janë inpute të paobservueshme për një pasuri apo detyrim.

### **(b) Pasuritë financiare**

**Njohja fillestare:** një pasuri financiare ose një detyrim financiar duhet të njihet në pasqyrën e pozitës financiare kur entiteti raportues bëhet palë e provizioneve kontraktuale të instrumentit.

### **Matja fillestare e instrumenteve financiare**

Të gjitha instrumentete financiare në fillim maten sipas kostos (vlerës së drejtë) plus në rastin e instrumenteve financiare të cilat nuk janë sipas vlerës së drejtë nepërmjet fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit.

### **Matja pasuese e instrumenteve financiare**

SNRF 9 i kategorizon të gjitha instrumentet financiare në tri klasifikime, ato të cilat maten sipas kostos së amortizuar, ato të cilat maten sipas vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes dhe ato të cilat maten sipas vlerës së drejtë nepërmjet të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse.

Klasifikimi dhe matja e instrumenteve financiare në masë të madhe bazohet në:

Modeli i biznesit për menaxhimin e pasurisë, në veçanti nëse objektivi është mbajtja e pasurisë financiare me qëllim të arkëtimit të rrjedhave kontraktuale të parasë. Pra, nëse rrjedhat e parasë janë pagesa të vetëm interesit në kryegjënë e mbetur dhe të kryegjësë, atëherë pasuria financiare matet sipas kostos së amortizuar.

Kur modeli i biznesit është edhe mbajtja e pasurisë financiare me qëllim të arkëtimit të rrjedhave të ardhshme të kontraktuara të parasë dhe shitja e pasurisë financiare dhe rrjedhat e parasë janë vetëm pagesat e kryegjësë dhe të interesit për saldon e kryegjësë, atëherë pasuria financiare matet



sipas vlerës së drejtë nëpërmjet të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse. Të hyrat nga interesi në pasuri të tilla njihen në mënyrë të njëjtë sikur pasuria të matej sipas kostos së amortuar

Në rrethana të tjera, pasuritë financiare normalisht maten sipas vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes. Pa marrë parasyh të mësipërmet kur investimet në ekuitet nuk mbahen për tregtim, një entitet mund të bëjë zgjidhje të parevokueshme që të matë këto investime sipas vlerës së drejtë nëpërmjet të ardhurave tjera gjithëpërfshirëse.

Dhe për fund një entitet, në njohjen fillestare, mund që të zgjedh në mënyrë të parevokueshme të matë një instrument financiar sipas vlerës së drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes nëse të bërit kështu eliminon ose zvogëlon në masë të madhe mospërputhjet në kontabilitet.

### (c) Prezantimi i instrumentit të përbërë.

SNK 32 kërkon që elementet e ekuitetit dhe detyrimit fillimisht të njihen ndarazi. Vlera bartëse në fillim vlerësohet duke matur vlerën e drejtë të një instrumenti të ngjajshëm që nuk ka element të konvertimit. Kjo arrihet duke llogaritur vlerën e tanishme të rrjedhave të ardhshme të parasë të instrumentit duke supozuar që nuk do të konvertohet në datën e maturimit (rrjedhat e parasë të pagesave të interesit dhe kryegjësë) të skontuara në normën e interesit që mbizotëron në treg për instrument të ngjajshëm pa të drejtë të konvertimit. Diferenca ndërmjet kësaj shume dhe arkëtimet e emetimit njihet si ekuitet.

### (d)

(i)	D	Banka	€4,000,000	
	K	Detyrimi		€4,000,000

Emetimi i aksioneve

	D	Detyrimi	€40,000	
	K	Banka		€40,000

Regjistrimi i kostove të transaksionit

(ii) Detyrimi më pas do të matet sipas kostos së amortizimit duke përdorur normën efektive të interesit:

	<b>€000</b>
Saldo në fillim – arkëtimet	4,000
Minus kostot e transaksionit	<u>(40)</u>
	3,960
Interesi efektiv (7.97% x 3,960)	316
Minus dividenda e paguar (6% x 4,000)	<u>(240)</u>
<b>Saldo në fund me 31 mars 2019</b>	<b>4,036</b>

5.

a) Jon Snow sh.a është themeluar disa vite më parë me qëllim të kryerjes së operacioneve në minierat e Skocisë. Kompania është e përfshirë në nxjerrjen, thyerjen dhe përpunimin e minierave të bakrit, shkrirjes dhe në fund rafinimit të bakrit në përbërje 99.99% metal të bakrit të cilin e shet tek klientët për eksport. Minierat e bakrit janë një biznes që kërkon shumë kapital dhe kërkon shuma të mëdha të shpenzimeve kapitale të denominuara në Dollar Amerikan. Shitjet e bakrit janë gjithashtu të faturuara në Dollar Amerikan. Por, valuta funksionale e Jon Snow sh.a është Euro.

Jon Snow sh.a bleu paisje të minierave nga një furnitor në Kanada me 1 janar 2017 me një kosto prej \$2 milion. Paisja fillimisht është vlerësuar të ketë jetë të përdorimit ekonomik prej 20 viteve me vlerë të mbetur prej \$200 mijë. Paisja është rivlerësuar në pajtim me modelin e rivlerësimit sipas SNK 16 *Pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe paisjet* me 31 dhjetor 2017 me një vlerë të drejtë prej \$1.9 milion. Përgjatë periudhës deri me 31 dhjetor 2018 jeta totale e përdorimit ekonomik dhe vlera e mbetur janë rishikuar në 16 vite dhe \$250 mijë respektivisht. Megjithatë, paisja është rivlerësuar me 31 dhjetor 2018 me një vlerë të drejtë prej \$1.85 milion.

Kurset e këmbimit valutor ishin si më poshtë:

Data	Kursi (Euro për Dollar Amerikan)
1 janar 2017	8.0
31 dhjetor 2017/1 janar 2018	8.5
31 dhjetor 2018	10.0

Kurset e datës së fundvitit duhet të merren edhe si kurse mesatare gjatë vitit

**Kërkohet:**

**Këshillo drejtorët e Jon Snow sh.a lidhur me çështjen e mësipërme duke treguar trajtimin e duhur në kontabilitet në pajtim me SNFR-të dhe llogarit shumat që duhet të raportohen në pasqyrat financiare të 31 dhjetor 2018. (12 pikë)**

(b) Kompania Davos sh.a ju ka paraqitur politikat e saj të propozuara të kontabilitetit të zerave të ndryshëm të pasqyrave financiare për tu rishikuar nga ju. Disa nga propozimet përfshijnë të më poshtmet:

- (1) Stoqet gjithmonë do të paraqiten sipas kostos.
- (2) Nuk do të ketë amortizim të pasurive të paprekshme.
- (3) Ndryshimet në normën e zhvlerësimit do të aplikohen retrospektivisht.

**Kërkohet:**

**Vlerëso përshtatshmërinë e politikave të mësipërme të propozuara të kontabilitetit. (8 pikë)**

5.  
a)

Paisja e minierave është e kontabilizuar sipas SNK 16 Pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe paisjet. Përkthimi i shumave në valutë të huaj do të jetë sipas SNK 21 Efektet e ndryshimeve në kurset e huaaja të këmbimit.

John Snow sh.a duhet të raportoj paisjen sipas vlerës së drejtë me 31 dhjetor 2018 pas rivlerësimit. Megjithatë, vlera e drejtë ne Dollar Amerikan duhet të përkthehet në Euro, valutën funksionale. Në pajtim me SNK 21 vlera e drejtë e fabrikës duhet të përkthehet në kursin e këmbimit në datën e rivlerësimit. Kjo do të jep një vlerë të drejtë me 31 dhjetor 2018 në prej €18.5 milion (\$1.85 milion x 10).

Ngarkesa e zhvlerësimit për vitin do të bazohet në vlerën bartëse më 1 janar 2018 minus vlerën mbetëse përgjatë jetës së mbetur me 1 janar 2018. Vlera bartëse ishte €16.15 milion (\$1.9 milion x 8.5). Jeta totale e vlerësuar së fundi e jetës ekonomike është 16 vite. Kjo na jep edhe 15 vite të mbetura nga 1 janar 2018. Vlera e rishikuar e mbetur prej \$250,000 duhet të përkthehet në Euro me kursin e përkohshëm me 31 dhjetor 2018 (data e llogaritjes së zhvlerësimit) që jep €2.5 milion (\$250,000 x 10). Ngarkesa e zhvlerësimit për vitin deri me 31 dhjetor 2018 pra do të jetë e barabartë me €910,000 (16.15 milion minus 2.5 milion/15 vite). Ngarkesa e zhvlerësimit do të raportohet në fitim ose humbje për vitin.

Një fitim nga rivlerësimi do të rrjedh me 31 dhjetor 2018 si në vijim:

	<b>€'000</b>
Vlera e drejtë me 31 dhjetor 2018	18,500
Minus shuma bartëse para rivlerësimit (16,150-910)	<u>(15,240)</u>
Total fitimi nga rivlerësimi	3,260

Çdo shumë e fitimeve që e rrit vlerën bartëse mbi shumën sipas modelit të kostos do të raportohet në TTGJ. Vlera bartëse sipas modelit të kostos është si në vijim:

	<b>€'000</b>
Kostoja historike \$2 milion x 8	16,000
Minus zhvlerësimi v/p 31 dhjetor 2017 (16,000 - 200 x 8.5)/20	<u>(715)</u>
	15,285
Minus zhvlerësimi v/p 31 dhjetor 2018 (15,285 -250 x 10)/15	<u>(852)</u>
Vlera bartëse sipas modelit të kostos me 31 dhjetor 2018	14,433

Vlera bartëse e paisjes para rivlerësimit prej €15.24 milion me 31 dhjetor 2018 veç se është mbi vlerën bartëse sipas modelit të kostos. Tërë fitimi nga rivlerësimi me 31 dhjetor 2018 do të raportohet në TTGJ.

## **b) Përshtatshmëria e politikave të kontabilitetit**

SNK 8 'Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet' aplikohet në selektimin dhe aplikimin e politikave të kontabilitetit, kontabilizimin e ndryshimeve në vlerësimet dhe reflektimi i korigjimeve të gabimeve të periudhave të mëhershme. Standardi kërkon pajtueshmëri me SNRF të caktuara që aplikohen për një transaksion, ngjarje ose gjendje, dhe jep udhëzime në zhvillimin e politikave të kontabilitetit për zëra të tjerë gjë që rezulton me informata përkatëse dhe të besueshme. Megjithatë, Davos sh.a-së i lejohet të përdor gjykimin kur një transaksion, ngjarje ose gjendje nuk mbulohet mjaftueshëm nga standardet e kontabilitetit ose vlerësojnë se pajtueshmëria e plotë me një standard të caktuar të kontabilitetit do t'i bëjë pasqyrat financiare çorientuese që do të ishte në konflikt me objektivin e pasqyrave financiare të përshkruar në Kornizë.

### Stoqet

Parimi themelor i SNK 2 *Stoqet* është që stoqet duhet të barten sipas kostos apo vlerës neto të realizueshme cilado që është më e ulët. Andaj, bartja e stoqeve vetëm sipas kostos mund të jetë në konflikt me parimin themelor. Por, nëse drejtorët besojnë fuqishëm se mallrat me të cilat do të tregtojnë Davos sh.a do të kenë gjithmonë vlerë me të lartë neto të realizueshme, atëherë politika nuk do ta afektoj negativisht vlerësimin e stoqeve. Për më tepër, politika mund të jetë e pranueshme vetëm nëse mallrat do të shiten nga Davos sh.a, që nënkupton kompania të ketë monopol. Në atë rast kompania mund të sigurohet se do të shes mbi koston

### Pasuritë e paprekshme

Amortizimi i pasurive të paprekshme përgjatë jetës së përdorimit duhet të reflektoj mënyrën e përfitimeve ekonomike që priten të përfitohen nga Davos sh.a, edhe pse metoda drejtvizore është zgjedhje e parë. Për më tepër, klasifikimi i pasurive të paprekshme në ato me jetë të kufizuar dhe ato me jetë të pakufizuar të përdorimit do të përcaktoj nëse pasuria është subjekt i amortizimit. Nëse Davos sh.a e klasifikon pasurinë e paprekshme si me jetë të pakufizuar atëherë nuk do të kërkohet amortizimi. Por, nëse ato klasifikohen si me jetë të kufizuar të përdorimit do të duhet t'i amortizoj ato. Andaj politika do të jetë në pajtueshmëri me kërkesat e SNK 38 *Pasuritë e Paprekshme* vetëm kur Davos sh.a ka vetëm pasuri të paprekshme të klasifikuara si me jetë të pakufizuar të përdorimit. Në këtë rast rishikimet për dëmtim duhet të bëhen çdo vit.

### Ndryshimi në zhvlerësim

SNK 8 'Politikat e Kontabilitetit, Ndryshimet në Vlerësimet Kontabël dhe Gabimet' thotë që ndryshimet në politikat e kontabilitetit dhe gabimet kontabilizohen në mënyrë retrospektive, përderisa ndryshimet në vlerësimet kontabël kontabilizohen në baza prospektive. Ndryshimi në normën e zhvlerësimit është ndryshim në vlerësimin kontabël andaj duhet të aplikohet në mënyrë prospektive. Por nëse Davos sh.a ka harruar të ngarkoj zhvlerësimin në pasqyrat e periudhës së më hershme atëherë ky gabim do të aplikohet në mënyrë retrospektive.